



Në bazë të nenit 163 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e RMV-së nr.178/21), neni 207 dhe 321 i Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup dhe nenit 21 dhe 49 nga Regullorja për kushtet e posaçme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe thirjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup numër 02-174/2 e datës 06.04.2021, e lidhur me Vendimin e Drejtorisë Rektoriale të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup nr. 02-1414/2 të datës 02.09.2026, 02-1390/2 të datës 02.09.2026, 02-1443/2 të datës 02.09.2026, 02-1365/2 të datës 02.09.2026, 02-1429/2 të datës 02.09.2026, 02-1394/2 të datës 02.09.2026, 02-1428/2 të datës 02.09.2026 dhe 02-1389/2 të datës 02.09.2026, Drejtoria Rektoriale e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup shpall:

KONKURS INTERN

Për angazhimin e demonstratorëve në fakultetet e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, për vitin akademik 2026/2027 edhe atë:

I. Për Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

- Nga fusha Historia e Artit dhe Arkitekturës (1) demonstratorë

II. Për Fakultetin e Shkencave të Informatikës

- Nga fusha Program i aplikuar (1) demonstratorë
- Nga fusha Shkencat kompjuterike dhe Inxhinieria (1) demonstratorë

III. Për Fakultetin e Shkencave Teknike

- Nga fusha e E biznesit (1) demonstratorë
- Nga fusha Inxhinieria e trafikut dhe transportit (1) demonstratorë
- Nga fusha e Ekonomisë (1) demonstratorë

IV. Për fakultetin e Shkencave Teknologjike

- Nga fusha e Teknologjisë ushqimore (2) demonstratorë

V. Për Fakultetin e Shkencave Sociale

- Nga fusha e Psikologjisë (3) demonstratorë
- Nga fusha e Administratës publike dhe menaxhimit me burimet njerëzore (1) demonstratorë
- Nga fusha Punë sociale dhe politikë sociale (2) demonstratorë
- Nga fusha Media dhe Komunikime ndërkulturore (1) demonstratorë
- Nga fusha e Sportit dhe Shkencave sportive (1) demonstratorë



VI. Për Fakultetin Juridik

- Nga fusha e Studimeve të drejtësisë (1) demonstratorë

VII. Për Fakultetin Ekonomik

- Nga fusha Ekonomia dhe Biznesi (4) demonstratorë

VIII. Për Fakultetin e Shkencave Humane

- Nga fusha e Gjuhës gjermane (2) demonstratorë
- Nga fusha e Gjuhës angleze (2) demonstratorë

Për demonstratorë mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme sipas Ligjit për Arsim të Lartë dhe është student në ciklin e dytë ose të tretë të studimeve në programin adekuat studimor.

Kriteriumet për notimin e kandidatëve janë siç vijon:

- a. mesatarja e përfundimit të studimeve deridiplomike (40% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- b. mesatarja nga lëndët e domosdoshme të programit studimor në të cilin kandidati ka kryer studimet deridiplomike (50% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- c. 10% nga intervista (notë nga kualiteti arsimor profesional të cilin do ta mbulojë)

Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë kryer studimet në universitetet të ranguar më lartë. (përlogaritet faktori i rëndësisë përkatësisht koeficienti sipas rangimit të Universitetit)

Që të zgjidhet kandidati duhet ti plotësojë kriteriumet minimale të parapara në Ligjin për Arsim të Lartë, Rregulloren për kushtet e posaçme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në thirje bashkëpunëtori në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup si dhe Statutin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

Demonstratori do të angazhohet minimum dy (2), por jo më shumë se në tre (3) lëndë, përkatësisht së paku gjashtë (6), deri maksimum dhjetë (10) orë në javë.

Për angazhim të plotë maksimal demonstratorit i takon kompenzim në shumë neto deri 10.000 denarëve në muaj.

Demonstratorët do të zgjidhen pas shpaljes së konkursit intern, për vitin akademik 2026/2027.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje
- Biografi të shkurtë CV (me kontakt telefon dhe e-mail adresë)
- Dëshmi se është student i ciklit të dytë ose tretë të studimeve në programin adekuat ose se është i regjistruar.
- Dëshmi se e ka të kryer ciklin e parë të studimeve sipas ECTS me 180 ose 240 ECTS kredi me mesatare në minimum 8,00.
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e parë të studimeve;
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e dytë të studimeve;
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e tretë të studimeve – nëse posedon;
- Vërtetim për njohjen e gjuhës Maqedone dhe Shqipe nëse studimet i ka të kryera në gjuhë tjetër.



Dokumentet duhet të dorëzohen në arkivin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rruga 1669, nr.11A kati i 3-të, Shkup.

Me dorëzimin e fletëparaqitjes kandidatët për demonstrator janë dakord për tu regjistruar në bazën e kandidatëve për demonstrator në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Dorëzimi i dokumenteve është së fundmi me 18.09.2026.

Me respekt,

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup